VENDIM
Nr. 26, datë 15.2.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E KONTRATËS PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË ZYRTARIT TË PËRPUTHSHMËRISË

Në mbështetje të neneve 16, pika 7, dhe 47 të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror" dhe neneve 15 dhe 26 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.2.2017, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike për miratimin e draftit të kontratës për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të përputhshmërisë,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e Kontratës për Ofrimin e Shërbimeve të Zyrtarit të Përputhshmërisë.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti